VENDIM
Nr.670, datë 8.10.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 19 e vendimit nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano